



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-19-8224-5-2-1/C242
14 Nr. 1421/19
Dt. 18.12.2019

KONTRATË PUNE

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **SARANDA Cakaj – Drejtoreshë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PUNËDHËNËSI**) , dhe
2. “ **Kompania Prishtina “sh.p.k, emri biznesit, me seli në Prishtinë, me ARBK: 810510190, të cilën e përfaqëson z. Rizah Azemi, në tekstin e mëtejme: PUNËMARRËSI,**

, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i QMF-së në Vushtrri – projekt dy vjeçar , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	82	2	4	5	2	1
Prokurimi Nr.	644	1	9	1	3	3	5	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Ndërtimi i QMF-së në Vushtrri, sipas projektit, dokumentacionit standard, Projektit dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-19-133-521.**
- 1.2 **Afati i fillimit të punimeve është 2 (dy) dite pas nënshkrimit të kontratës, pasi të jetë bërë kërkesa nga Menaxheri i Kontratës i Punëdhënësit për fillim të punimeve dhe në rast se kushtet klimatike, nga palët nënshkruese të kësaj Kontrate, vlerësohen të përshtatshme për punë.**
- 1.3 **Punëdhënësi obligohet që para fillimit të punimeve t’ia dorëzoi Punëmarrësit tërë dokumentacionin e kompletuar të projektit në fjalë.**
- 1.4 Projekti do të realizohet brenda periudhës dy vjeçare : **2019 dhe 2020 respektivisht brenda 200 ditëve pune (e hënë – e shtunë) nga data e fillimit të punimeve, sipas dinamikës, si vijon :**
 - në vitin kalendarik 2019 – aq ditë sa ekzistojnë kushtet për ekzekutim të punimeve, marrë parasysh datën respektivisht kohën e lidhjes së Kontratës;

- në vitin 2020 , aq ditë pune sa kanë mbetur, por jo më shumë se 200 ditë pune nga data e fillimit të ekzekutimit të punimeve, ndërsa afati i përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas afatit të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, jo më gjatë se **data: 20.10.2020.**
- 1.5 Punëdhënësi, menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate, do të emëroi Menaxherin e Kontratës si dhe Organin Mbikëqyrës duke i përcaktuar edhe përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me realizimin e kësaj Kontrate dhe ekzekutimin e projektit.
- 1.6 Punëmarrësi obligohet që, në kërkesë me shkrim të Punëdhënësit apo organit të autorizuar prej tij, të kryej edhe punë tjera shtesë të paparapara lidhur me projektin në fjalë, por që nuk do të filloi me punimet shtesë përderisa me Punëdhënësin nuk arrihet marrëveshje- aneks kontratë me shkrim për të specifikuar punët dhe çmimin.
- 1.7 Vetëm Autoriteti Kontraktues mundë ti miratoi ndryshimet, modifikimet, shmangiet dhe zëvendësimet në Përshkrimin e Punës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto çështje.
- 1.8 Punëmarrësi ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Punëdhënësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.
- 1.9 Punëmarrësi do të penalizohet me shumën prej 0,10% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të pajustificuar të kryerjes së punëve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.
- 1.10 Punëmarrësi, përmes afatit garantues i cili nuk mundë të jetë më i shkurtë se 12 muaj, e siguron Punëdhënësin se punët dhe detyrat e besuara janë kryer me një cilësi të lartë dhe sipas konditave të përcaktuara me projekt dhe sipas dispozitave të LMD-së që rregullojnë këtë çështje.
- 1.11 Garantimi i cilësisë së punëve nga ana e Punëmarrësit do të bëhet në afatin dhe në institucionin e përcaktuar si në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pjesë e dosjes së tenderit.
- 1.12 Afati garantues fillon nga dita e pranimit teknik të përkohshëm të objektit.
- 1.13 Punëmarrësi obligohet që, brenda afatit kohorë garantues, me ftesë- kërkesë të Punëdhënësit t'i eliminoi, me shpenzime të tija, gjitha të metat eventuale të shfaqura në objekt me fajin e tij dhe atë në afatin prej 5 ditësh pune nga dita e dërgimit të ftesës.
- 1.14 Në rast se Punëmarrësi në afatin e paraparë nuk i ndërmerr veprimet për eliminimin e të metave, Punëdhënësi të metat e paraqitura do ti eliminoi përmes angazhimit të një punë kryesi tjetër, e në barrë të Punëmarrësit, duke shfrytëzuar mjetet financiare të depozituara me Garancion të Sigurimit të Cilësisë.
- 1.15 Punëmarrësi nuk do të përgjigjet për të metat e shfaqura si pasojë e shfrytëzimit – përdorimit joadekuat të objektit të pranuar. Me këtë rast për bazë do të mirën dispozitat e LDM-së që rregullojnë këtë çështje.
- 1.16 Gjatë kryerjes së punimeve do të udhëhiqet libri ndërtimorë dhe ditari i punës sipas normave ligjore në fuqi, ndërsa Punëdhënësi apo organi i autorizuar prej tij do ti vërtetoi punimet e kryera sipas dinamikës, konformë specifikimit në para masë , para llogari dhe planin dinamik të punëve.

Pranimi teknik i objektit

- 1.17 Pas përfundimit të punimeve Punëmarrësi do të kërkoj pranimin teknik të përkohshëm të objektit të përfunduar, ndërsa Punëdhënësi do të zbatoi procedurat e pranimit teknik të përkohshëm të objektit dhe atë nga momenti kur Menaxheri i Kontratës dhe Organi Mbikëqyrës i Punëdhënësit e njoftojnë, me shkrim, Punëdhënësin mbi përfundimin e gjitha punëve të paparapara.
- 1.18 Në pajtim me Kërkesat e saktësuara si ë Kushtet e Veçanta të Kontratës, Punëmarrësi do të depozitoi Sigurimin e Kualitetit të Punëve në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, për një periudhë

garantuese të defekteve prej 13 muaj nga data e pranimin teknik të përkohshëm në emër të shumës së mbajtur së parasë

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **346.222,00€ (treqinddyzetegjashttmijdyqindnjëzetedy/00Euro).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.

2.4 Ashtu sikurse është rregulluar edhe me dispozita të Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e dosjes së tenderit si dhe duke qenë se projekti në fjalë është projekt afatgjatë (dy vjeçar), ndërkaq prokurimi për realizimin e projektit nxitë ngritjen e obligimeve financiare të Autoritetit Kontraktues – Punëdhënësit që duhen përmbushur nga përvetësimet në vitin fiskal 2019 dhe 2020 , palët kontraktuese pajtohen që dinamika e realizimit të punëve në projektin në fjalë të realizohet në harmoni me dinamikën e përvetësimeve të mjeteve financiare në këtë vit, 2019, në pajtim me pjesën e lëndës së kontratës – pjesë e dosjes së tenderit me nr. prok. 644 – 19 – 133 – 521, respektivisht dinamika e realizimit të projektit të realizohet, me sa vijon :

- Në vitin kalendarik 2019, deri në shumën prej : 190.000,00€, nëse kushte dhe koha për ekzekutim të punimeve premt, dhe
- Ndërsa në vitin kalendarik 2020 deri në shumën: 156.222,00€, sipas planifikimeve buxhetore dhe nevojave dhe kërkesave për përvetësime financiare të Autoritetit Kontraktues – Punëdhënësit që duhen planifikuar dhe përvetësuar – siguruar nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë.

2.5 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.

2.6. Shuma e pagesës në avans nuk aplikohet.

2.7 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimin Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

3.3 Në rast të paqartësisë apo mospërputhshmërisë lidhur me dispozitat e kësaj kontrate, palët do ti marrin për bazë dispozitat e përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse e dosjes së tenderit me **nr. të brendshëm të prok. 644 – 19 – 133 - 521.**

3.4. Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë (Departamenti për Çështje Ekonomike), ndërsa për bazë do të merren dispozitat e përcaktuara si në dokumentacionin – Dosjen e Tenderit me **nr. të brendshëm të prok. 644 – 19 – 133 - 521.**

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **shqipe**¹ në katër origjinale, dy prej të cilave 3 janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Kontraktuesin :

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj	Emri:	Rizah Azemi
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik	Pozita:	Përfaqësues i O.E. " Kompania Prishtina "sh.p.k. – Prishtinë
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	18.12.2019	Data:	18.12.2019
Vula:		Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuhët në përdorim zyrtarë.

Siguria e ekzekutimit	10.1	<p>Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është : 10 % e çmimit total të kontratës, nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, apo kompani e sigurimeve e licensuar nga BQK</p> <p>Afati i validitetit i Sigurimit të Ekzekutimit deri me datë 20/11/2020.</p>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi i ekzekutimit	12.1	<p>Planin për Menaxhimin e Kontratës.</p> <p>Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës</p> <p>Përfundimi i punëve bëhet si vijon në vitin 2019 30 ditë , ndërsa në vitin 2020 170 ditë sipas planit të menaxhimit të kontratës dhe jo më largë se datë 20.10.2020 , pasi që projekti është projekt dy (2) vjeçar.</p> <p>Punët do të realizohen sipas përvetësimeve buxhetore nga Autoriteti Kontraktues nëpër vite</p>
	12.2	<p>Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.</p>

Numri i prokurimit: **VU644-19-8224-5-2-1** apo nr. i brendshem: **VU644-19-133-521**
Titulli: Ndërtimi i QMF-së në Vushtrri

Tatimet dhe marrëveshjet doganore	15.1	Gjitha detyrimet doganore dhe tatimore sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, bien në barrë të Op.Ek. - Kontraktuesit
Patentat dhe licencat	13.1	N/A
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : 2 (dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës dhe jo më largë se datë 20.10.2020 , pasi që projekti është projekt 2 (dy) vjeçar
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni I Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar enkas nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve- shërbimeve të Autoritetit Kontraktues.
Pagesa	24.2	Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit-situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake.
Mbajtja e Parasë	27.1	
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë jo me vonë se 2 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 36 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Deklarata garantuese me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur për tërë vlerën e përgjithëshme të kontratës, me afat validiteti për periudhën pre 37 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.

Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	44.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

Numri i prokurimit: VU644-19-8224-5-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-19-133-521 Titulli: Ndërtimi i QMF-së në Vushtri

Shënimi: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G

Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, 18, e jo në formatin **0%, 8% apo 18%**

Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, Po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve te prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion.

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
I	Punët e Rrënimt të Objektiv Ekzistues								
1.1	Para fillimit te punimeve te konsultoheni me org. mbikqyres për mënyrën e ekzekutimit të punimeve , dhe masat mbrojtëse para fillimit të punimeve , njoftimi i organeve kompetente si policin , zjarfiksat, KEDS dhe gjate gjithë kohes te ketë në dispozicion ambulancën ,për nevoja shëndetësorë .	1	1.00	423.73	18.00	500.00	423.73	76.27	500.00
1.2	Përgaditja e kanjërif duke marrë masa mbrojtëse si rrethoja metalike ne lartesi h=2,0m'për pjesën nga rruga e cila është e frequenture ,dhe për këtë pjesë montohen edhe skele në lartësi h=15,5m duke l rrethuarë me rrjeta mbrojtëse dhe shirta sinjalizues , dhe shenjat të cilat janë në fuksion të siuads	m ²	240.00	4.24	18.00	5.00	1,016.95	183.05	1,200.00
1.3	Organizimi punishtes duke oganzahuare edhe mauna me ujë me presion gjate gjithë kohes së rrenimit , dhe materiale tjera të nevojshme për ekzekutimin e punëve sipas normave teknike në fuqi	paushal	1.00	211.86	18.00	250.00	211.86	38.14	250.00

1.4	Organizimi i makoneris së nevojshme për fillimin e punëve , duke përfshirë eksevatore të tipit të lartë , ngarkues , dhe gjatë ekzekutimit të punimeve të jene në dispozicion edhe 6 (gjashtë) kamion për barteje deri në 10 m³.	1	1.00	84.75	18.00	100.00	84.75	15.25	100.00
1.5	Të gjitha materialet të cilat janë në objekt duhet me kujdesë të dilokohen , demontohen duke përfshirë dyert , dritarët ,dhe materialet tjera të nevojshme të cilat janë pjesë e objektit duke filluarë nga konstruksioni i kulmit të cilat do të ngarkohen dhe transportohen në vendin e caktuarë ng a org. mbikqyrës	paushal	1.00	2,118.64	18.00	2,500.00	2,118.64	381.36	2,500.00
1.6	Gjatë ekzekutimit të punimeve duhet të jete në funksion edhe kamion me „cesternë " për skperkthjen e materialëve gjatë rrënimt gjatë gjithë kohës së punës .	1	1.00	423.73	18.00	500.00	423.73	76.27	500.00
1.7	Rrënimimi I objektit me sipërfaqe bruto S=350,5m² me etazhitet :dhe P+1+NK nga materiali blloke argjilore, tulla të plota, plaka betoni , shytylla betoni themele betoni dhe themele guri , e gjitha materiali të ngarkohët , transportohët në deponi legale e përcaktuare nga investitori në distancë L=16,8km	m³	3150.00	2.12	18.00	2.50	6,673.73	1,201.27	7,875.00
1.8	Me përfundimin e punimeve operatori obligohët që të gjitha materialet të mbetura të themeleve ti ngarkoj , transportoj në vendin e caktuarë më lartë dhe të panifikoj terrenin dhe mos të metet material nga objekti egzistues .	m²	883.50	0.85	18.00	1.00	748.73	134.77	883.50
TOTALI I:							11,702.12	2,106.38	13,808.50
II	Punët e Ndërtimit								
1	Punët përgaditore								

1.1	Inqizimi I parcelles ne vendin e parapare per ndertimin e ambulances , si dhe bartja e pikave nga proekti ne terren se bashku me organin mbikqyres	Copë	1.00	296.61	18.00	350.00	296.61	53.39	350.00
1.2	Pastrimi I parcelles nga mbeturinat e mundshme, materiali largohet ne deponi legale.	Copë	1.00	84.75	18.00	100.00	84.75	15.25	100.00
1.3	Punimi i rrethojës së kantierit. Rrethoja duhet punuar me material të qëndrueshëm të pakën lllamarinë se zingtuar me lartësi 2 m.	Copë	1.00	8.47	18.00	10.00	8.47	1.53	10.00
1.4	Punimi i objekteve përcjellëse për nevoja të kantierit.Këtu përfshihen hapësira zyrat e menaxhimit të kantierit, mbikëqyrësin si dhe hapësirat për punëtorë (garderobat dhe trapezaria)	Copë	1.00	84.75	18.00	100.00	84.75	15.25	100.00
2	Punët e Dheut								
2.1	Germimi ne thellesi h=0.20 cm per largimin e humsyt, materiali I germuar largohet ne deponi legale	m ³	100.00	2.12	18.00	2.50	211.86	38.14	250.00
2.2	Gërmimi i dheut të kategorisë së III -të për hapjen e bodrumit dhe largimi i të njëjtit në largësi brenda kantierit për përdorim në rregullimin e oborrit, pjesa e teperet dhe e podobishme largohet ne deboni	m ³	1296.00	2.12	18.00	2.50	2,745.76	494.24	3,240.00
2.3	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit nën themelet-e objektit në trashesi d= 15.0 cm mbi dheun e ngjeshur me mekanizim përkatës	m ³	54.15	8.47	18.00	10.00	458.90	82.60	541.50
2.4	Furnizimi , hudhja dhe ngjeshja e gurit te thyer-perberje natyrore perreth dhe nen pllaken e dyshemes	m ³	108.30	8.47	18.00	10.00	917.80	165.20	1,083.00
2.5	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit në trashesi d= 15.0 cm mbi perberjen natyrore e ngjeshur me mekanizim përkatës	m ³	54.15	8.47	18.00	10.00	458.90	82.60	541.50

3 Punët e Betonit										
3.1	Furnizimi dhe betonimi i shtresës së betonit me beton të ngjeshur C 15/16 ne trashesi d = 4-6 cm nen pllakën	m ³	36.00	46.61	18.00	55.00	1,677.97	302.03	1,980.00	
3.2	Furnizimi dhe betonimi i themel i pllakës me trashësi dhe t=40cm me beton te armuar C25-30 dhe mueve te bodrumit në pahitë përkatëse sipas projektit. Siperfaqja e jashtme e pahive te jete e lemuar .	m ³	242.00	55.08	18.00	65.00	13,330.51	2,399.49	15,730.00	
3.3	Furnizimi dhe betonimi i mureve të liffit me trashësi t=20cm me beton te armuar C25-30 Mpa në pahitë përkatëse sipas projektit. Siperfaqja e jashtme e pahive te jete e lemuar	m ³	25.00	55.08	18.00	65.00	1,377.12	247.88	1,625.00	
3.4	Furnizimi dhe betonimi i shkallve me beton te armuar C25-30 Mpa në pahitë përkatëse sipas projektit. Siperfaqja e jashtme e pahive te jete e lemuar .	m ³	26.00	55.08	18.00	65.00	1,432.20	257.80	1,690.00	
3.5	Latimi dhe betonimi i trajeve dhe pllakave konstruktive metrashëis t=20cm beton te armuar C25-30 Mpa në pahitë përkatëse sipas projektit. Siperfaqja e pahive te jete e lemuar .	m ³	290.40	55.08	18.00	65.00	15,996.61	2,879.39	18,876.00	
3.6	Latimi dhe betonimi i shtyllave me beton të armuar C25-30 në kallupet përkatëse sipas projektit.	m ³	39.16	55.08	18.00	65.00	2,156.85	388.23	2,545.09	
3.7	Furnizimi dhe betonimi I elementeve tjera konstruktive si parahyrjet, hyrjet shkallet arkitrajt etj. Me beton C25-30 ne kallupet perkatese sipas projektit.	m ³	14.00	55.08	18.00	65.00	771.19	138.81	910.00	

3.8	Furnizimi dhe betonimi i trotuarit per reth objektit me trashesi t=10.0 cm e ndare ne qdo 2 m me fuge dilatuese ne llogari te merret edhe rrieta Q 188 dhe rampes për hyrjes të vetuarve në bodrum	m ²	14.40	8.47	18.00	10.00	122.03	21.97	144.00
3.9	Furnizimi i materialit dhe punimi i shtreses se estrihut ne pllaken e dyshemes me makinë me trashësi 5-7cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese striporit t=3cm dhe shtreses hidroizoluese.	m ²	1269.00	4.24	18.00	5.00	5,377.12	967.88	6,345.00
3.1	Furnizimi i materialit dhe punimi i shtreses mbrojtëse (estrih) me makinë me trashësi 4-5 cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese striporit t= 8cm nen konstrukcionin e kulmit	m ²	420.00	3.39	18.00	4.00	1,423.73	256.27	1,680.00
4	Punët e Armaturës dhe Konstruksionit Metalik								
4.1	Blerja, transporti, preja si dhe vendosja e ARMATURËS ÇBR-400/500 Mpa në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike:cca	kg	62977.20	0.55	18.00	0.65	34,690.83	6,244.35	40,935.18
4.2	Blerja, transporti, preja si dhe vendosja e ARMATURËS Rrjetë në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike	kg	11284.00	0.55	18.00	0.65	6,215.76	1,118.84	7,334.60
5	Punët e Muratimit								
5.1	Furnizimi dhe muratimi i mureve te jashtme me blloka te argjiles d=25cm me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit.	m ³	92.00	33.90	18.00	40.00	3,118.64	561.36	3,680.00

5.2	Furnizimi dhe muratimi i mureve te mbrendshme me blloka te argjiles d=12cm , muri me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit .	m ²	119.00	13.56	18.00	16.00	1,613.56	290.44	1,904.00
5.3	Furnizimi dhe muratimi i mureve te mbrendshme me blloka te argjiles d=20cm me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit .	m ³	95.60	33.90	18.00	40.00	3,240.68	583.32	3,824.00
5.4	Furnizimi dhe muratimi i mureve te mbrendshme me blloka te argjiles d=25cm me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit .	m ³	28.00	33.90	18.00	40.00	949.15	170.85	1,120.00
5.5	Furnizimi dhe muratimi i mureve te atikes me blloka te argjiles d=20 cm , muri me llaq vazhdues ne perpjese 1:2:6 ne teresi sipas projektit, per llogari te merret shtangimet vertikale dhe horizontale me beton arme .	m ³	30.00	33.90	18.00	40.00	1,016.95	183.05	1,200.00
5.6	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të brendshme dhe plafonit me llaq gelqeror në perpjesë 1:3 në dy shtresa me finalizim të lëmuar. Ne pozicion të parashihet vendosja e kendoreve ne kandet e mureve.	m ²	2416.48	3.39	18.00	4.00	8,191.46	1,474.46	9,665.92
6	Punët e Kulmit								
6.1	Furnizimi, punimi dhe montimi i konstrukcionit të kulmit komplet mbi pllakë, nga druri i përpunuar, në tërësi sipas projektit. Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshhtë	m ²	342.97	15.25	18.00	18.00	5,231.75	941.71	6,173.46

6.2	Furnizimi dhe vendosja e dërrasave t=24 mm mbi konstrukcionin kulmit, si bazament për vendosjen e letrës difuzive dhe listelave. Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshhtë	m ²	342.97	3.39	18.00	4.00	1,162.61	209.27	1,371.88
6.3	Furnizimi dhe vendosja e kontra listelave 2/4 cm në çdo 70cm mbi dyshemenë e dërrasave per krijimin e siperfaqes ajruese . Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshhtë	m ²	342.97	0.85	18.00	1.00	290.65	52.32	342.97
6.4	Furnizimi dhe vendosja e listelave 5/8 në çdo 80 cm mbi kontralistela . Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshhtë	m ²	342.97	1.69	18.00	2.00	581.31	104.63	685.94
7	Punët e Llamarinës								
7.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i mbulesës së kulmit me llamarinë të plastifikuar dhe valëzuar me shtresën kundër kondenzit. LV-4 në ngjyrë sipas zgjedhjes së investitorit. Llogaria në m2 në sipërfaqe të rrafshhtë	m ²	342.97	8.47	18.00	10.00	2,906.53	523.17	3,429.70
7.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve horizontal nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm.	m ²	20.60	6.78	18.00	8.00	139.66	25.14	164.80
7.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i ullukëve vertical nga llamarina e plastifikuar me dimensione Φ 120cm, t=0.55mm	m ¹	13.60	6.78	18.00	8.00	92.20	16.60	108.80
7.4	Furnizimi dhe montimi i llamarinës së plastifikuar me ngjyrë sipas investitorit për punimin e mveshjeve të oxhakut	Copë	1.00	42.37	18.00	50.00	42.37	7.63	50.00
7.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i mveshjes horizontal dhe vertikale e mureve te atikes nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm. Me gjeresi zhvilluese mesatare 0.8m. Lidhja duhet te behet ne menyre shume profesionale	m ¹	57.40	8.47	18.00	10.00	486.44	87.56	574.00

8 Punët e Hidroizolimit dhe Termoizolimit									
8.1 Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal i themel plakës ,mureve të bodrumit me saldim të lidhjeve ne pllaken e dyshemes, hidroizolimi punohet me material hidroizolues shumështrësor - tipi kondor, t=4mm dhe me nje shtrese lyerje bituliti. Llogaria ne m2 ne llogari te merren paraprakishte izolimi edhe para vendosjes se muratures	m ²	817.96	15.25	18.00	18.00	12,477.36	2,245.92	14,723.28	
8.2 Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal në dysheme dhe vertikal në lartësi h=30cm me saldim të lidhjeve në muret e kthinave sanitare, me material hidroizolues shumështrësor - tipi kondor, me dy shtresa t=3mm dhe në mes të shtresave lyerje me bitulit.	m ²	64.96	4.24	18.00	5.00	275.25	49.55	324.80	
8.3 Furnizimi dhe shtrirja e letres difuzive mbi sipërfaqen paraprakisht të mveshur me dërrasa të konstruksionit te kulmit, perfshire te gjitha punet pergatitore .Llogaria per m ² bazës së kulmit	m ²	342.97	0.85	18.00	1.00	290.65	52.32	342.97	
8.4 Furnizimi dhe vendosja e materialit termoizolues me trashësi t=8.0 cm e cila vendoset mbi pllaken e kulmit, sipas projektit. Në çmim të llogaritët edhe shtresa mbrojtëse e termoizolimit folja plastike.	m ²	342.97	3.39	18.00	4.00	1,162.61	209.27	1,371.88	
9 Punët e Zdrukthtarisë									

9.1	<p>Furnizimi dhe montimi i dritareve prej materialit të plastikës me trashësi të profilit t=8.0cm me min. 5 komora (hapesira termike) dhe tre mbyllje gome. Plastika te jete e perforcuar me profil te çelikut (d=2mm) , adekuat per profilin e caktuar te PVC-se. Profili duhet te arrihet vlerat Uf prej 1.3 ë/m2. Dritaret do të jenë me XHAM TE TREFISHT 4+16+4+16+4 mm, Uë=0,8 ë.m-2K-1, 1 mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, izolimi akustik Rë-34 dB. Mekanizmi për hapje jo më lartë se 175 cm. Të aplikohet sistem katërshresor mbrojtës SIKKENS (apo të ngjajshme) me impregnim të thellë.</p>									
9.1.1	Pos B1 me dimensione 150X250 cm	Copë	3.00	317.80	18.00	375.00	953.39	171.61		1,125.00
9.1.2	Pos B2 me dimensione 80x80 cm	Copë	18.00	67.80	18.00	80.00	1,220.34	219.66		1,440.00
9.1.3	Pos B3 me dimensione 160x180 cm	Copë	13.00	245.76	18.00	290.00	3,194.92	575.08		3,770.00
10.1.4	Pos B4 me dimensione 220x80 cm	Copë	3.00	149.15	18.00	176.00	447.46	80.54		528.00

9.1.5	<p>Furnizimi si dhe montimi i Fasades strukturale nga profilet e Aluminit M4 të prodhuesit Alumil ose ngjashëm, si dhe me xham StopSol "pasqyrë" termopan 6+12+6mm dhe me dimension minimal (Xhami i jashtëm i kalitur apo dyshtrësorë me folje ngjitëse në mes).</p> <p>Hapësira ajrore të jetë e mbushur me Argon. Ne kuader te fasades strukturale ekzistojne 10 hapje kiper. Kërkojen atestet nga prodhuesi dhe qertifikatat e kualitetit të Klasit të parë nga institucionet e akredituara, dhe ankerimet e fasades strukturale me te gjitha elementet .</p>	m ²	130.00	93.22	18.00	110.00	12,118.64	2,181.36	14,300.00
9.2	<p>Furnizimi dhe montimi i dverve të hyrjes prej materialit të plastikës me trashësi të profilit t=8.0cm me min. 5 komora (hapësira termike) dhe tre mbyllje gome. Plastikë të jetë e perforcuar me profil te çelikut (d=2mm) , adekuat per profilin e caktuar te PVC-se.Profilin duhet te arri në vlerat Uf prej 1.3 ë/m2. Dyert do të jenë me XHAM TE TREFISHT 4+16+4+16+4 mm, Uë=0,8 ë.m-2K-1, mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, izolimi akustik Rë-34 dB.Mekanizmi për hapje jo më lartë se 175 cm. Të aplikohet sistem katërshtresor mbrojtës SIKKENS (apo të ngjajshme) me impregnim të thellë.</p>								
9.2.1	Pos A1 me dimensione 300X270 cm	Copë	2.00	686.44	18.00	810.00	1,372.88	247.12	1,620.00
9.2.2	Pos A8 me dimensione 240X270 cm	Copë	1.00	550.85	18.00	650.00	550.85	99.15	650.00

